

V E N D I M
Nr.309, datë13.5.1997

**PËR KRIJIMIN E KUSHTEVE LEHTËSUESE PËR FUSHATËN ELEKTORALE NË
KUADRIN E GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME**

Në mbështetje të ligjit nr.8194, datë 2.3.1997 "Për gjendjen e jashtëzakonshme në rastet e cenimit të rëndë të rendit kushtetues dhe të rendit publik", ndryshuar me ligjin nr.8199, datë 20.3.1997

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

1. Ngarkohen organet kompetente për të marrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin e sigurimit të kushteve për veprimtaritë politike të partive me rastin e hapjes së fushatës elektorale.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e caktimit të datës së zgjedhjeve.